

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Oper. Sistemi, Trans.dhe Tregu- KOSTT SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i prokurimit	KOSTT-26-234-1-1-1
Nr i brendshëm	KOSTT023/126-2-26-11-111

Sa i përket tenderit për

Furnizimi me TMRR dhe TMT 220kV dhe 110kV dhe shkarkues të mbitensionit (220kV)

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Risamont SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Brahim Ademi, Bregu i Diellit

(Adresa)

Prishtinë

10 000

(Vendi)

(Kodi postar)

+38349393528

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Riad Rexhepi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

risamont@gmail.com

(Adresa elektronike)

24.04.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Njoftimi për Kontratë: 28.01.2026
Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 11.03.2026
Njoftimi i Vendimit të AK: 07.04.2026
Njoftimi i i Vendimit të AK në KRS: 14.04.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Procesi i hapjes është bërë nëpërmes platformës E-Prokurimi.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Bashkangjitur keni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin e AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 51 i LPP-së
Neni 53 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 65-71 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së

** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pergjegja e AK ne kerkesen per rishqyrtim e dates: 14.04.2026

AK ka refuzuar kerkesen per rishqyrtim ne te gjitha pikat, dukei listuar si meposhte:

Përfaqja e AK: Refuzohet Pretendimi në tërësi

Pretendimi 1:

Autoriteti Kontraktues refuzon këtë pretendim si të pabazuar, pasi kërkesa për "CE" ka qenë qartë e përcaktuar në Dasjen e Tenderit, konkretisht në Technical Data Sheet, në pikën:

1.4 – Country of Origin – Required: CE

Kjo kërkesë nënkupton se produktet e ofertuara duhet të jenë në përputhje me kërkesat për tregun evropian ("Certified for Europe – CE"), dhe operatorët ekonomik kanë qenë të obliguar të dëshmojnë këtë përputhshmëri përmes dokumentacionit përkatës.

Kërkesa e Autoritetit Kontraktues gjatë fazës së sqarimeve për dorëzimin e certifikatës CE apo Deklaratës së Konformitetit nuk përbën ndryshim apo shtim të kërkesave, por vetëm një kërkesë për dëshmi konkrete të një kriteri tashmë të specifikuar në FDT.

Në përputhje me nenin 72 të LPP-së, AK ka kërkuar sqarime me qëllim të verifikimit të përmbushjes së kërkesave ekzistuese dhe jo për të vendosur kriteret e reja.

Pretendimi refuzohet si i pabazuar.

Te gjeturat:

Me kete rast vet AK e verteton se kerkesa per certifikaten CE nuk ka qene kerkesa e specifikuar ne FDT, mirepo vetem standardet IEC e te cilat dy prodhuesit i plotesojne, pervec ne datasheet dhe katalog, gjithashtu nje gje te tille e kan konfirmuar permes deklarave respektive.

Kerkesa e AK per scarime lidhur me certifikaten CE, po e citoj:

Dokumentacioni i kërkuar: Ju lutemi të prezantoni Certifikatën CE ose Deklaratën e Konformitetit (EC Declaration of Conformity) për produktet e ofruara (TRA-123 nga Euromek dhe ZIPOL-J/192 nga DİSAŞ). Ky dokument duhet të vërtetojë që produktet janë prodhuar dhe testuar në përputhje me direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian dhe standardet harmonizuara.

Deklarata e prodhuesve i gjeni si dokumente shtojce Anex 1 dhe Anex 2. me theks te vecant:

3. The product is designed, manufactured, and tested in accordance with the relevant IEC 61869-1 and IEC 61869-2 standards, which govern performance, safety, and dielectric requirements for high-voltage instrument transformers. Compliance with these standards is ensured through type and routine tests, independent of CE marking obligations.

Based on the above, CE marking is not applicable to the aforementioned product under the current EU harmonization legislation.

ENGINEERING AND DESIGN MANAGER

Erdem TEKİN



DEPUTY GENERAL MANAGER

Nurkan AKTAŞ



- 3- The product is designed, manufactured and tested in accordance with the relevant IEC-60099-4/5 (Metal Oxide Surge Arresters without gaps for A.C. systems) standard. Compliance with this standard is ensured through type and routine tests, independent of CE marking obligations.

Based on the above, CE marking is not applicable to the aforementioned product under the current EU harmonization legislation.

Hasim GOLAR, Elec. Eng.

Factory manager



Pretendimi 2:

Autoriteti Kontraktues refuzon këtë pretendim si të pabazuar dhe sqaron se kërkesa për "CE" nuk është vendosur në mënyrë arbitrare gjatë vlerësimit, por ka qenë e përcaktuar qartë në Dosjen e Tenderit, konkretisht në Technical Data Sheet, pika:

1.4 – Country of Origin – Required: CE

Kërkesa "CE" është përdorur nga AK për të nënkuptuar që produktet duhet të jenë të destinuara dhe në përputhje me kërkesat e tregut evropian ("Certified for Europe"), dhe operatorët ekonomik kanë qenë të obliguar të dëshmojnë këtë përputhshmëri përmes dokumentacionit përkatës.

Pretendimet e OE lidhur me interpretimin e legjislacionit të BE-së për aplikueshmërinë ose jo të shenjës CE nuk e lirojnë atë nga detyrimi për të përmbushur kërkesat e përcaktuara në FDT. Në rast se OE ka vlerësuar se forma e dëshmisë nuk është përmes shenjës CE, ka pasur mundësinë të paraqesë dokumente ekuivalente (p.sh. Deklaratë Konformiteti apo dëshmi tjera zyrtare) që vërtetojnë përputhshmërinë me tregun evropian.

Pretendimi refuzohet si i pabazuar.

Te gjeturat:

Me kete rast vet AK e verteton se kerkesa per certifikaten CE nuk ka qene kerkesa e specifikuar ne FDT, mirepo vetem standardet IEC e te cilat dy prodhuesit i plotesojne, pervec ne datasheet dhe katalog, gjithashtu nje gje te tille e kan konfirmuar permes deklaratave respektive.

Kerkesa e AK per scarime lidhur me certifikaten CE, po e citoj:

Dokumentacioni i kërkuar: Ju lutemi të prezantoni Certifikatën CE ose Deklaratën e Konformitetit (EC Declaration of Conformity) për produktet e ofruara (TRA-123 nga Euromek dhe ZIPOL-J/192 nga DİSAŞ). Ky dokument duhet të vërtetojë që produktet janë prodhuar dhe testuar në përputhje me direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian dhe standardet harmonizuara.

Deklarata e prodhuesve i gjeni si dokumente shtojce Anex 1 dhe Anex 2.
me theks te vecant:

Certificate No: 2026-D-002

Date of Issue: 17.02.2026

We, EUROMEK, hereby declare that the product listed below:

- **Product:** 126 kV Oil-Immersed Current Transformer
- **Model:** TRA-123
- **Rated Voltage:** 126 kV

does not fall within the scope of mandatory CE marking, based on the following technical and regulatory justification:

1. The product is a high-voltage instrument transformer with a rated primary voltage of 126 kV, which is outside the voltage limits defined in the EU Low Voltage Directive (2014/35/EU), applicable only to equipment operating between 50–1000 V AC.
2. The current transformer is of conventional passive design, containing no electronic or digital components that would subject it to the Electromagnetic Compatibility Directive (2014/30/EU).
3. The product is designed, manufactured, and tested in accordance with the relevant IEC 61869-1 and IEC 61869-2 standards, which govern performance, safety, and dielectric requirements for high-voltage instrument transformers. Compliance with these standards is ensured through type and routine tests, independent of CE marking obligations.

Based on the above, CE marking is not applicable to the aforementioned product under the current EU harmonization legislation.

ENGINEERING AND DESIGN MANAGER

Erdem TEKİN



DEPUTY GENERAL MANAGER

Nurkan AKTAŞ



T./F. +90 312 666 90 56 • euromek@euromek.com.tr • Alcı OSB Mh. 2014. Cd. No:27 Sincan/Ankara/Türkiye
euromek.com.tr

Ankara, 23.03.2026

REF:

Declaration on non-applicability of CE marking

We, DİSAŞ, hereby declare that the product listed below:

Product:

High Voltage, Station Type, Metal-Oxide Surge Arrester in Silicone Housing with rated voltage (Ur) 192 kV and Continuous Operating Voltage (Uc) 153 kV, Class: 3 (SM)

Model : ZIPOL-J / 192

does not fall within the scope of CE marking based on the following technical and regulatory justification:

- 1- The product is a high-voltage surge arrester with a rated voltage of 192 kV, which is outside the limits defined in EU Low Voltage Directive (2014/35/EU) applicable only to equipment operating between 50 – 1000 V AC.
- 2- The surge arrester contains no electronic or digital components that would subject it to the Electromagnetic Compatibility Directive (201/ 34 / EU)
- 3- The product is designed, manufactured and tested in accordance with the relevant IEC-60099-4/5 (Metal Oxide Surge Arresters without gaps for A.C. systems) standard. Compliance with this standard is ensured through type and routine tests, independent of CE marking obligations.

Based on the above, CE marking is not applicable to the aforementioned product under the current EU harmonization legislation.

Hasim GOLAR, Elec. Eng.

Factory manager

DİSAŞ
DİŞJONKTÖR VE ELEKTRİK MALZEMELERİ
İMALAT SANAYİ VE TİCARET A.Ş.
Büyükdere Mah. Çiğdem Sk. No:220 06750 Beşiktaş/İstanbul
Yatırım Girişim No: 1328



Pretendimi 3:

Autoriteti Kontraktues ka vepruar plotësisht në përputhje me nenin 72 të LPP-së, duke i dhënë mundësi OE që të sqarojë dhe plotësojë dokumentacionin e munguar.

Kërkesa për sqarim ka qenë e njëjtë në natyrë me kërkesat e FDT-së dhe nuk ka përbërë ndryshim të kriterëve, por vetëm një verifikim të përmbushjes së tyre.

OE ka pasur mundësi të barabartë për të ofruar dëshmi shtesë, por nuk ka dorëzuar dokumentacion të mjaftueshëm për të vërtetuar përputhshmërinë.

Pretendimi refuzohet si i pabazuar.

Te gjeturat:

Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar konform nen72 te LPP-se, perkundrazi ka vepruar ndesh me nenin 7 te LPP pasi qe per te njejtat deshmi qe OE i propozuar per kontrate nuk i ka dorezuar me oferten, AK nuk i ka kerkuar fare pyetje scaruese.

Ndersa ne i kemi derguar scarimet adekuate konform kerkeses se AK Duke konfirmuar se produktet jane te prodhuara dhe atestuara ne perputhje me direktivat e Bashkimit European dhe standardet e harmonizuara.

Deklarata e prodhuesve i gjeni si dokumente shtojce Anex 1 dhe Anex 2.

Pretendimi 4:

Autoriteti Kontraktues ka trajtuar të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese.

Të gjithë operatorët janë vlerësuar mbi bazën e dokumentacionit të dorëzuar dhe përputhshmërisë me kërkesat e FDT-së.

Pretendimi refuzohet si i pabazuar.

Te gjeturat:

Autoriteti Kontraktues ka vepruar ndesh me nenet 7 dhe 72 te LPP-se, pasi qe per te njejtat deshmi qe OE i propozuar per kontrate nuk i ka dorezuar me oferten, AK nuk i ka kerkuar fare pyetje scaruese.

Rast edhe me i rende eshte ateher kur AK si dokument te mireqene pranon nje dokument te OE te propozuar per kontrate, respektivisht Sqarim per Shkarkues te mbitensionit ku thuhet: Ne duam te sqarojme se shkarkuesit e mbitensionit me te cilet kemi ofertuar jane konform standardeve CE, pa ofruar asnje deshmi apo refernce te standardeve te kerkuar.



Dalian Hivolt Power System Co., Ltd.

FOR A SAFE POWER LINE !

Clarifications

Date: 03/09/2026

To: whom it may concern

We are [DALIAN HIVOLT POWER SYSTEM CO.,LTD], who are official manufacturers

of [surge arrester insulator], having factories at [No. 2804 , 75 Huili Street , Ganjingzi

District, Dalian 116031, China]. We would like to clarify that our offered surge arresters comply

with CE standards.

Authorized representative of the Manufacture



Ndersa per transformatore te rrymes dhe te tensionit, AK nuk ka kerkuar fare sqarime lidhur me certifikaten CE, edhe pse per te njejtin OE i propozuar per kontrate me oferte nuk ka dorezuar ndonje dokument, certifikate apo deklarate qe e sqaron kete pike.

Pervec tjerash, OE i propozuar per kontrate per te gjitha pozicionet e ofertuara, nuk ka ofruar fare katalog ashtu sic eshte e specifikuar ne FDT, po e citoj:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2

Kapaciteti teknik dhe profesional

Katalogët për produktet e kërkuara.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

OE duhet të prezantoj Katalogun për produktet e ofertuar, ku precizohen sakte karakteristikat teknike

Me kete rast AK ka vepruar ndesh me nenet: 7, 72 dhe 59 te LPP, duke propozuar per kontrate oferten e OE te papergjegjshem.

Pretendimi 5:

Autoriteti Kontraktues sqaron se OE i propozuar për kontratë ka dorëzuar dokumentacion të mjaftueshëm për të dëshmuar përputhshmërinë e produkteve me kërkesat teknike dhe standardet e kërkuara.

Pretendimi refuzohet si i pabazuar.

Te gjeturat:

OE i propozuar per kontrate per te gjitha pozicionet e ofertuara, nuk ka ofruar fare katalog ashtu sic eshte e specifikuar ne FDT, po e citoj:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2

Kapaciteti teknik dhe profesional

Katalogët për produktet e kërkuara.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

OE duhet të prezantoj Katalogun për produktet e ofertuar, ku precizohen sakte karakteristikat teknike

Me kete rast AK ka vepruar ndesh me nenet: 7, 72 dhe 59 te LPP, duke propozuar per kontrate oferten e OE te papergjegjshem.

Pretendimi 6:

Autoriteti Kontraktues refuzon këtë pretendim si të pabazuar.

Në përputhje me nenin 27 të LPP-së – Kriteret e Dhënies së Kontratës, konkretisht pika 27.1 (a), kriter i dhënies së kontratës në këtë aktivitet prokurimi ka qenë: “tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët”.

Kjo nënkupton se përzgjedhja nuk bazohet vetëm në çmimin më të ulët, por në çmimin më të ulët të një oferte që është e përgjegjshme, pra që përmbush të gjitha kërkesat administrative dhe teknike të përcaktuara në FDT.

Te gjeturat:

Ne pretendimin e 6-shte, AK bie ndesh me nenin 27 te LPP-se, pasi qe ka propozuar per kontrate OE qe eshte i papergjegjshem me kriteret e percaktuara ne FDT, respektivisht AK ka ra ndesh me nenet: 7, 59 dhe 72 te LPP-se, pasi qe:

1. Ka aplikuar masa diskriminuese e qe bien ndesh me nenin 7 te LPP,
2. Ka deshtuar ne vleresimin e ofertave konform nenit 59 te LPP dhe
3. Per OE te propozuar per kontrate nuk ka kerkuar scarime lidhur me dokumentacionet e munguara ne oferte e qe bie ndesh me nenin 72 te LPP.

Me date: 07.04.2026 kemi pranuar Vendimin e Autoritetit Kontraktues, nga ku ne si OE i pergjegjshem jemi eleminuar nga AK me pretendimet e meposhtme:

'Nuk posedoni certifikate CE per produktet e ofertuara per te cilat eshte kerkuar certifikate ne fjale. '

Me date: 07.04.2026 kemi kerkuar qasje ne dokumente, ku edhe na jane derguar dokumentet e OE te propozuar per kontrate.

Pasi qe kemi analizuar te gjitha dokumentet e pranuar, ateher kemi ardhë deri te perfundimet te cilat po i eleboroje meposhte.

Te gjeturat:

Sipas kerkesave te AK te specifikuara ne FDT, respektivisht:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Pretendimi i pare:

Kapaciteti teknik dhe professional:

TMRR dhe TMT 220kV dhe 110kV dhe shkarkues të mbitensionit për tensionin 220kV duhet të jenë në përputhje me standardet të IEC-së (IEC 60044-1 për TMRR dhe IEC 60099-4, IEC 60099-5 për shkarkues mbitensionit).

Dëshmi dokumentare:

Ofertuesi të dorëzoj si dëshmi se TMRR dhe TMT 220kV dhe 110kV dhe shkarkues të mbitensionit për tensionin 220kV do të jenë në përputhje me standardet të IEC-së (IEC 60044-1 për TMRR dhe IEC 60099-4, IEC 60099-5 për shkarkues mbitensionit)..

Kerkesat e AK ne FDT:

Kerkesa e AK e specifikuar ne FDT ishte se produktet duhet te jene konform standardeve IEC dhe se askund nuk kerkohet certifikata CE, pasi qe e njejta nuk eshte e aplikueshme dhe nuk lejohet te aplikohet konform direktivave te BE, po e citoj:

*'Bazuar në rregullat strikte të Bashkimit European, markimi CE nuk është një zgjedhje, por një detyrim që zbatohet **vetëm** për produktet që përfshihen në direktivat specifike të "Harmonizimit Teknik". Për produktet si transformatorët dhe shkarkuesit e mbitensionit të tensionit të lartë vendosja e shenjës CE nuk është vetëm e panevojshme, por **teknikisht e ndaluar** sipas legjislacionit të BE-së (p. 1).*

1. Përfshirja nga Direktiva e Tensionit të Ulët (LVD 2014/35/EU):

*Sipas kësaj direktive, markimi CE është i detyrueshëm vetëm për pajisjet elektrike që operojnë brenda kufijve të tensionit midis **50 V dhe 1000 V AC** (p. 1). Produktet në fjalë (126kV dhe 192 kV) operojnë shumë mbi këta kufij, prandaj ligjërisht bie jashtë fushëveprimit të kësaj direktive (p. 1).*

2. Ndalea sipas Rregullores (EC) Nr. 765/2008:

*Neni 30 i kësaj rregulloreje europiane përcakton se: "Është e ndaluar vendosja e markimit CE në produkte që nuk parashikohen nga legjislacioni i harmonizimit të Komunitetit". Pasi pajisjet e tensionit të lartë nuk mbulohen nga asnjë direktivë që kërkon shenjën CE, vendosja e saj do të përbënte **shkelje ligjore** dhe keqpërdorim të markës (p. 1).*

3. Mungesa e Komponentëve Elektronikë (2014/30/EU):

Pajisja nuk i nënshtrohet as Direktivës së Pajtueshmërisë Elektromagnetike (EMC), pasi nuk përmban pjesë aktive elektronike që mund të shkaktojnë ose të ndikohen nga ndërhyrjet elektromagnetike (p. 1).

4. Validimi përmes Standardeve IEC:

*Në mungesë të markimit CE, siguria dhe performanca dëshmohen përmes konformitetit me standardet **IEC 60099-4** dhe **IEC 60099-5**, pavarësisht detyrimeve për shenjën CE (p. 1).*

Scarimet:

Duke ju referuar *Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë*, si dhe mare parasyshe se oferta jone ka çmimin me te lire nga te gjithë OE pjesmarres, me theks te veçant nga **OE i propozuar per kontrate per vleren: 5.050,25€**, ateher AK ka qene e detyruar te aplikoj *Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë* dhe te sqaroj te gjitha pyetjet per tu scaruar konform *Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë* sipas kerkesave te dhena ne FDT, mirepo jo te bie ndesh me *Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi*, pasi qe ne kerkesen per scarime AK ka derguar nje shkrese per scarime, po e citoj:

'Certifikimi CE: Ne tabelen e te dhenave teknike , Autoriteti kontraktues ka kerkuar specifikisht qe "Vendi i Origjines" te jete CE (certifed for Europe). Megjithese ne oferten tuaj e keni specifikuar vendin e Orgjines Turqi, ne dosje mungon dokumenti zyrtare CE i leshuar nga prodhuesi ose trupi certifikues.

Dokumentacioni i kerkuar: Ju lutemi te prezantoni certifikaten CE ose Deklaraten e Konformitetit (Ec Declaration of Conformity) per produktet e ofertuara (TRA-123 dhe ZIPOL-J/192 nga Disas). Ky dokument duhet te vertetoj se produktet jane prodhuar dhe testuar ne perputhje me direktivat perkatese te Bashkimit European dhe standarder e harmonizuar'

Komenti:

Në lidhje me kërkesën tuaj për sqarim mbi "Certifikimin CE" për produktin (TRA-123 dhe ZIPOL-J/192 nga Disas), neve ju kemi informuar permes deklaratave te prodhuesve se produktet, duke qenë pajisje e tensionit të lartë (126kV dhe 192 kV), sipas rregulloreve të Bashkimit European, **nuk mbart dhe nuk lejohet të mbartë shenjën CE. Anex 1, Anex 2** Megjithatë, ato përmbushin të gjitha kriteret teknike të kërkuara përmes pikave si vijon:
Mos-aplikimi i Shenjës CE: Sipas Direktivës 2014/35/EU (Direktiva e Tensionit të Ulët), markimi CE është i detyrueshëm vetëm për pajisjet që operojnë midis 50V dhe 1000V AC.

Produktet që operojnë mbi këtë tension (si (TRA-123 dhe ZIPOL-J/192 nga Disas)) janë jashtë fushëveprimit të kësaj direktive.

Gjithashtu, sipas Rregullores (EC) Nr. 765/2008, neni 30, ndalohet vendosja e shenjës CE në produkte për të cilat nuk ekziston një direktivë specifike e BE-së që e kërkon atë.

Konformiteti me Standardet e BE-së: Produktet janë projektuar dhe testuar në përputhje të plotë me standardet: IEC 60044-1 (apo versioni i ri IEC 61869-1 dhe 2), IEC 60099-4 dhe IEC 60099-5. Këto standarde janë të transpozuar plotësisht në Bashkimin Europian si standarde EN (Euronorm), çka dëshmon se produktet plotësojnë të gjitha kërkesat teknike dhe të sigurisë që aplikohen në tregun europian.

Garantimet se produkti i ofruar është plotësisht "Certified for Europe" (CE) sa i përket standardeve teknike, pavarësisht se shenja grafike CE nuk vendoset mbi pajisje për shkaqe ligjore të BE-së.

Ne kete rast AK ka vepruar ndesh me **Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë** pasi qe AK ka devijuar kerkesat nga ato te dhena ne FDT ku CE certifikata nuk kerkohej, mirepo kerkohej qe produktet te jene te prodhuara konform standardeve IEC.

Gjithashtu AK ka rene ndesh me **Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi** pasi qe oferten teknike te OE te propozuar per kontrate e ka pranuar si te mireqene pa certifikate CE, pa kerkuar fare scarime ashtu sic na jane drejtuar neve si **OE me oferten teknike te pergjegjshme dhe me te lire se i OE te propozuar per kontrate per vleren 5.050,25€.**

Rasti edhe me i keq eshte ather kur AK ka pranuar si te mireqene nje deklarata ne forme te scarimit per prodhuesit te shkarkuesve e cila ka kete permbajtje, po e citoj:

*'Ne deshirojme te japim scarimet lidhur me produktet e shkarkuesve te mbitensioneve se te njejtit jane ne pajtueshmeri me standardet CE' **Anex 3***

Scarim: Certifikata CE nuk eshte standard, mirepo eshte marke e cila permbane ne vete standardet specifike, varesisht nga produktet per te cilat leshohet, respektivisht per produktet qe lejohet te markohen me certifikaten CE.

Gjithashtu, per prodhuesin e transformatoreve rrymore dhe atyre te tensionit, AK nuk ka kerkuar fare scarime lidhur me certifikate CE nga OE i propozuar per kontrate ashtu sic na jane drejtuar neve si **OE me oferten teknike te pergjegjshme dhe me te lire se i OE te propozuar per kontrate per vleren 5.050,25€.**

Si perfundim gjeneroz, AK ka vepruar ndesh me te gjitha nenet e listuara ne piken:

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues, me theks te veçant :

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.

3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasisë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

5. Autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose (ii) që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos furnizojë ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik. Në rast se një kërkesë e tillë është veçanërisht e autorizuar nga ky ligj, ndonjë ligj tjetër ose marrëveshje ndërkombëtare, parametrat e saktë të një kërkesë të tillë do të saktësohen në kontratë ose në njoftimin e konkursit të projektimit, ftesën për pjesëmarrje ose tenderim, dhe në dosjen e tenderit.

6. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë;

(i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit;

(ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj;

(iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik;

(iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit;

(v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse.

Njëkohësisht AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, ku edhe pse ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “*Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*, mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Ndërsa pika (vi) e paragrafit 6 e nenit 7 të LPP-së e përcakton qartë që “që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-se që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **Risamont SH.P.K.**

Te anulohet Vendimi i AK dhe procesi te kthehet ne rivleresim, përndryshe ne do të detyrohemi të vazhdojmë me ankesa dhe kundërshtime për këto shkelje në instancat tjera më të larta.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Kostot e tilla do te llogariten ne fazat vijuese.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*